



## A K T   T H E M E L U E S

### I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE “ 2 L X ” SH.P.K.

Une **Gjergj Kadeli**, i biri i Pjetrit, dtl 29.01.1966, banues Fshati Tresh, Zejmen, Lezhe, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7512 date **10.08.1991** “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit ”, te ligjit Nr.7638 date **19.11.1992**, “ Per shoqerite tregetare ”, dhe te ligjit Nr. **8770** date 19.04.2001 “ Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike ”, krijoj shoquerine tregetare private me perjegjesi te kufizuar “ **2 L X** ” dhe me aktin themelues te saj si vijon:

### F O R M I M I

#### NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur “ **2 L X** ” sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

### SELIA E SHOQERISE

#### NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private “ **2 L X** ” sh.p.k. do te jetë : Lagja “ Beselidhja ”, Pall. Nr. 102, Lezhe.

### O B J E K T I   I   V E P R I M T A R I S E

#### NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

- Sherbimit dhe Ruajtjes fizike :
- a – Sigurimit te objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdonim te personave fizike e juridike, qe ushtrojne veprimitari ne republiken e Shqiperise.
- b – Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personava fizike, shtetas shqiptare ose te huaj.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per kategorite “ **a + b** ” ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

- Eksport Import dhe perdonim te paisjeve dhe produkteve elektrike dhe elektronike, dixhitale dhe speziale, mjeko sanitare, instalim, mirembajtje dhe kurse formimi.

NENI 4

Per kryerjen e veprimitarise se saj shoqeria do te hape objekte, njesi sherbimi dhe ruajtjeje dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.

### KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestari i shoqerise tregetare private “**2 L X**” sh.p.k. do te jete 4.000.000 (kater milion) leke. dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali fillestari mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresish i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

### DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortaku themelues i shoqerise z. **Gjergj Kadeli** i cili eshte dhe perfaqesues ligjor i saj, ndersa konform ligjit **Nr. 8770** date 19.04.2001 drejtues teknik do te jete z. **Fran Ndoj**.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut themelues te shoqerise.

## NENI 10

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

## NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne gjykaten e shkalles se pare Lezhe.

## NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

## NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit **Nr.7638 date 19.11.1992** “Mbi krijimin e shoqerive tregetare” dhe te Ligjit **Nr. 8770 date 19.04.2001** “Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike”

## NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

## NENI 15

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbeten ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private **“2 L X” sh.p.k.**

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“2 L X” sh.p.k.**

Gjergj Kadeli



# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ 2 L X ”

Ne baze te ligjit **Nr.7512** date **10.08.1991** “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit ”, te ligjit **Nr.7638** date **19.11.1992**, “ Per shoqerite tregetare ”, dhe te ligjit **Nr. 8770** date 19.04.2001 “ Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike ” me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Akitit Themelues:

Une **Gjergj Kadeli**, i biri i Pjetrit, dtl 29.01.1966, banues, Fshati Tresh, Zejmen, Lezhe, hartoj Statutin e shoqerise si me poshte:

### EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

#### NENI 1

Shoqeria emertohet “ **2 L X** ” sh.p.k.

#### NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private “ **2 L X** ” sh.p.k. do te jete : Lagja “ Beselidhja ”, Pall. Nr. 102, Lezhe.

#### NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e :

- Sherbimit dhe Ruajtjes fizike :
- a – Sigurimit te objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdonim te personave fizike e juridike, qe ushtrojne veprimitari ne republiken e Shqiperise.
- b – Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personava fizike, shtetas shqiptare ose te huaj.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per kategorite “ **a + b** ” ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

- Eksport Import dhe perdonim te paisjeve dhe produkteve elektrike dhe elektronike, dixhitale dhe speziale, mjeko sanitare, instalim, mirembajtje dhe kurse formimi.

## KAPITALI I SHOQERISE

### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregetare private “ **2 L X** ” sh.p.k. do te jetë 4.000.000 (kater milion) leke. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

### NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te palujteshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

### NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar sigurohet nga ortaku themelues, i derdhur ne banke dhe eshte i regjistruar ne librin e llogarise te shoqerise.

### NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

### NENI 9

Shoqeria tregetare “ **2 L X** ” sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregetare “ **2 L X** ” sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### NENI 10

Shoqeria tregetare “ **2 L X** ” sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku themelues i shoqerise mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortaku themelues i shoqerise z. **Gjergj Kadeli** i cili është dhe perfaqesues ligjor i saj, ndersa konform ligjit Nr. 8770 date 19.04.2001 drejtues teknik do te jete z. **Fran Ndoj**.

NENI 12

Hijne brenda detyrave dhe kopetencave te ortakut themelues si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne puna dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 13

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i cakton ortaku themelues i shoqerise ka edhe keto detyra e te drejta:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaku themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te perqigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryej veprimitari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimitarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj per zgjerimin e veprimitarise.
6. Te punesoje punonjes te thjeshte dhe te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

#### NENI 15

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimitarine e saj.

### MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

#### NENI 16

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimitarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

#### NENI 17

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni finanziar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

#### NENI 18

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### NENI 19

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

## NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjate vtitit finansiar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vtitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi " Rezerve e domosdoshme ", deri sa ky fond te arrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

## NENI 21

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondev te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdonim ortakut themelues te shoqerise.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

## DISPOZITA TE VEÇANTA

## NENI 22

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

## SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

## NENI 23

Shndrrimi i shoqerise " 2 L X " sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.

## NENI 24

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese. (ortaku i vetem themelues)

Ne keto raste, pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Likuidatori eshte perjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhë te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe i takojne atij.

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.


NENI 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private “**2 L X**” sh.p.k.

## ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“**2 L X**” sh.p.k.

Gjergj Kadeli



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr... 86.4....Rep

Nr.....Kol

Tirane me 4. 11. 2005

## VERTE TIM

Sot me dt. 4.11. 2005 u paraqit para meje zoti Gjergj Kadeli, madhor, i panjohur personalisht prej meje, per identitetin e te cilit u njoha nga dokumenti identifikues Nr. 419 ( certifikate ) leshuar nga zyra e gjendjes civile Zejmen date 21.10.2005, i cili deklaroit se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plete dhe nenshkruehet pa verejtje ne pranine time dhe une e vertetoj sipas ligjit.

## NOTERE

NOTE RE  
MARGENA CELA  
CEL: 069 21 624